

## NJOFTIM

**MBI APLIKIMIN E APLIKUESIT “RONC ENERGIA ALBANIA” SH.P.K., PËR  
NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “MARIO” ME KAPACITET PRODHUES  
DERI NË 2 MW, NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË PËRROIT TË  
KRASHNËS DHE VILANIT, DEGË E LUMIT SHKUMBIN,  
BASHKIA LIBRAZHD, QARKU ELBASAN**

Në përputhje me Ligjin nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe VKM nr. 822 datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, Aplikuesi “Ronc Energia Albania” sh.p.k., ka aplikuar në ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), për miratimin e ndërtimit të hidrocentralit “Mario”, me kapacitet prodhues deri në 2 MW, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Krashnës dhe Vilanit, degë e lumit Shkumbin, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.

- Shoqëria “Ronc Energia Albania” sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me objekt të aktivitetit: Studimin, projektimin, sipërmarrjen zbatuese dhe investimin për realizimin me fonde publike dhe jo publike të hidro-elektro centraleve, HEC-eve financimin, vënien në punë, administrimin, prodhimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e pajisjeve të prodhimit të energjisë elektrike si dhe ndërtimin e paneleve të kontrollit të HEC, etj linjave të transmetimit të energjisë elektrike për tregtimin e saj, konsulence teknike në fusha të ndryshme, supervizion, menaxhime dhe studime të të gjitha llojeve, realizimi i kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkta apo forma të tjera si dhe të realizojë tregtimin dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme, industriale, ushqimore, mjekësore, të ndërtimit, të mediave, të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit etj. Riparimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha mjeteve e makinerive të nevojshme për procesin si dhe prodhimin në vend të mjeteve, makinerive dhe pjesëve të ndryshme në funksion të aktivitetit. Ndërtime, projekte të të gjitha kategorive. Ndërtimit, projektimit dhe zbatimit, ndërtime civile e ekonomike shumëkatëshe, ndërtime rrugore, vepra arti, ujësjellësa, kanalizime, kanale e impiante vaditëse, vepra të vecanta e punime speciale, punime restaurimi, punime karpenterie, shërbime publike, punime armature, murature, suvatime. Rrugë autostrada, mbikalime, hekurudha tramvaje, pista aeroportuale. Ndërtime dhe punime detare, lumore, punime thellimi në ujë, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Punime nëntokësore, diga e tunele hidroteknike. Gjithashtu do të kryhet çdo veprimtari e lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi me qëllim përmbushjen e objektit tregtar të shoqërisë.

Një informacion më i detajuar lidhur me projektin mund të gjendet pranë Drejtorisë së Parteneritetit Publik Privat për Energjinë në Ministrinë e Infrastrukturas dhe Energjisë.

Objeksionet ose komentet lidhur me këtë aplikim mund të dërgohen në adresën e mëposhtme brenda 15 ditësh nga data e publikimit të parë.

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.**

**Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit**

**Blvd. Dëshmorët e Kombit, 1001**

**Tiranë**